



Të nderuar-a lexuese dhe lexues,

Mirë së vini në Buletin e tretë, i cili shtypet në kuadër të projektit.

"Avokimi dhe ngritja e kapaciteteve për gratë vendimmarrëse në Rajonin e Pejës".

Projekti ka për qëllim të ndërtoj kapacitete dhe të avokoj për implementimin e mekanizmave institucional për pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse, përmes trajnimeve në barazinë gjinore, lobim dhe ngritje të spikatjes së grave në politikë.

"Pa kundërshtime s'ka përparim, ky është ligj të cilin qytetërimi e ka trashëguar deri më sot" Diogjeni



Nga takimi i Grave Asambleiste të Regjionit të Pejës me Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga

Temë e takimit" Roli i Gruas në proceset vendimmarrëse"

Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, ka vlerësuar lart rolin e gruas kosovare në aspektin politikë, ekonomik dhe shoqëror. Duke potencuar prezencën dhe fuqinë më të madhe të saj. Presidentja ka kërkuar më shumë mundësi që do t'i ofronin gruas vendin e duhur në shoqëri.

"Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i denjë i gruas në çdo segment të punës dhe jetës është një sfidë me të cilën përballen të gjitha vendet e botës, pavarësisht nivelit të tyre të zhvillimit. Barazia gjinore është e drejtë dhe parim i cili duhet të respektohet në nivelin qendror dhe atë lokal, prandaj edhe do të kërkoj nga institucionet përkatëse që ky parim të ketë trajtim të duhur, ka thënë Presidentja e vendit.

Ajo i ka bërë këto komente gjatë një takimi me Gratë Vendimmarrëse të Rajonit të Pejës, që e kishte iniciuar OJQ 'Zana' Klinë. Ky takim është cilësuar si një kanal shtesë i komunikimit në mes të nivelit lokal dhe atij qendror.

Sipas saj, vendet ku hendeku gjinor është më i vogël, janë vende më prosperuese që ofrojnë politika më gjithëpërfshirëse. Në këtë rrafsh, Jahjaga ka thënë se Kosova ka marrë praktikën më të mira, të dala nga Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë.

Si rezultat i kësaj, ka shtuar Jahjaga, mbi 30 për qind e ligjvënësve të Kuvendit janë gra dhe disa ministri dhe procese kyçe udhëhiqen nga gratë.

"Këto rezultate janë indikatorë pozitivë të progresit, kur kemi parasysh që shumë vende ende nuk e kanë arritur këtë nivel të përfaqësimit", ka thënë znj. Jahjaga, duke lënë hapësirë edhe për më shumë punë.

Roli i Gruas në Qeverisjen Lokale



Bashkimi bën fuqi!

"Në këtë periudhë transitorë, nëpër të cilën po kalojmë ne, duhet të synojmë të arrijmë në atë pikë të zhvillimit dhe përparimit demokratik, kur caktimi i kuotave të mos jetë më i nevojshëm, sepse gruaja, si e barabartë, e aftë dhe profesionalisht e përgatitur, konkurron barabartë me mashkullin për secilin pozicion në shoqëri", ka deklaruar Presidentja.

Ajo po ashtu ka thënë se shkalla e edukimit dhe e shkollimit të gruas në Kosovë nuk është e kënaqshme, ndërsa niveli i braktisjes së shkollës si dhe analfabetizmit është shumë më i lartë te femrat sesa te meshkujt. Një gjë e tillë, sipas znj. Jahjaga, ndikon drejtpërdrejt në nivelin e punësimit të gruas, në llojin e punës që ajo bën dhe në pagën e saj, si dhe në mënyrën e jetesës për të dhe familjen.

E kënaqshme, po sipas Presidentes, nuk është as gjendja e gruas në ekonomi, ndërmarrje dhe biznes. Ajo ka kujtuar shifrat, sipas të cilave, gratë zotërojnë vetëm 8 për qind të pasurisë së patundshme të Kosovës dhe vetëm 6 për qind të bizneseve.

Si rekomandime nga ky takim janë:

1. Angazhim për Barazi Gjinore në të gjitha nivelet
2. Pavarësim ekonomik të gruas dhe edukim
3. Respektim të kuotës në të gjitha nivelet
4. Të dërgohet shkresë në MAPL që të respektohet Ligji dhe se njëri nga të dy nënkryetarët në Komunë të jetë femër.

Po ashtu gjatë takimit me Presidenten: për situatën dhe gjendjen e Gruas në Vendimmarrje në Rajonin e Pejës, e ka njoftuar edhe Drejtoresha Ekzekutive e OJQ-së "ZANA" znj. Tahire Gashi, si dhe kryetarët e Grupeve të Grave Asambleiste të Regjionit të Pejës.



Kur flitet për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, kryesisht nënkuptohet avancimi i pozitës së gruas në shoqëri, e në veçanti në jetën publike dhe në pozita vendimmarrëse. Barazi gjinore do të thotë "pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë, si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi". Shoqëria jonë, vazhdimisht ka bërë përpjekje për arritjen e barazisë gjinore, e në veçanti avancimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe jetën publike.

Institucionet e Kosovës në vazhdimësi kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar mundësi dhe trajtim të barabartë pa dallime, përfshirë edhe dallimet gjinore. Në disa raste, janë ndërmarrë edhe masa afirmative që çojnë drejt arritjes së barazisë gjinore siç janë caktimi i kuotave gjinore apo të ngjashme.

Legjislacioni në fuqi në Kosovë, promovon dhe inkurajon arritjen e barazisë gjinore e në veçanti promovimin e pjesëmarrjes së gruas në procesin e punës, si dhe në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse.

Legjislacioni në Kosovë ofron një bazë të mirë për inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së gruas në procesin e punës, por edhe në pozita vendimmarrëse. Ky legjislacion promovon fuqishëm parimin e barazisë gjinore. Ndërkaq, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, akti më i lartë juridik dhe politik i vendit, përveç se në gjuhën dhe strukturën e saj ka një balance gjinore, ajo respekton dhe promovon parimet e barazisë gjinore, që janë të pranuar edhe ndërkombëtarisht (Neni 71). Për më tepër, Kushtetuta ndalon çdo formë të diskriminimit përfshirë edhe diskriminimin në baza gjinore. Një parim i tillë është më tej i sanksionuar me Ligjin Kundër Diskriminimit, i cili promovon parimin e barazisë gjinore dhe kundër diskriminimit në baza gjinore (Neni 2), duke paraparë edhe sanksione për personat fizik dhe juridik, që shkelin dispozitat e këtij ligji (Neni 9.2).

Fusha e zbatimit të këtij ligji mbulojnë jo vetëm institucionet publike, por edhe ato private, duke përfshirë edhe p r i m e t a p o mosveprimet edhe të personave fizikë (Neni 4).

Ligji për Barazi Gjinore, synon të mbroj, trajtoj dhe vendos, barazi ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore (Neni 1.1).



Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi (Ligji për barazi gjinore)



Buletini apo letra iformuese shtypet në kuadër të këtij projekti që po e implementon OJQ "Zana" në Klinë. Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.



Ky ligj përcakton një sërë masash ligjore për arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese.

Për më tepër, ky Ligj përshkruan në mënyrë mjaft të hollësishme obligimet dhe përgjegjësitë e institucioneve publike për të garantuar barazinë gjinore. Ligji kërkon nga institucionet publike që të ndërmarrin masa ligjore dhe afirmative për arritjen e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre të popullata e përgjithshme e Kosovës (Neni 3.1).

Sipas Departamentit të Administratës për Shërbimin Civil (DASHC) është raportuar që në nivel drejtues (komunal dhe qendror) kanë qenë 50 femra në vitin 2008, ndërsa 67 në vitin 2009. Sa i përket gjendjes vetëm në nivelin lokal, për vitin 2010, në pozita drejtuese nga një total prej 318, gratë zënë 26 vende, ndërsa në pozita menaxheriale, nga një total prej 1859, 361 janë gra.

Është me se evident që numri i grave në ekzekutiv, në nivelin lokal, nuk është në përqindjen që në do deshironim, por duhet patur parasysh që në shumicën e rasteve shkollimi është përcaktues për sigurimin e vendit të punës apo pozitës së caktuar.

Institucionet e krijuara, si Agjencia për Barazi Gjinore apo edhe mekanizmat tjerë si në nivel qendror po ashtu edhe në nivel lokal, janë mekanizma të rëndësishëm për sigurimin e barazisë gjinore, dhe inkurajimin e grave për pjesëmarrje më të madhe në proceset vendimmarrëse.

Shoqëria jonë vazhdimisht ka bërë përpjekje për arritjen e barazisë gjinore, e në vecanti avancimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe jetën publike.

Janë rritur përpjekjet jo vetëm për emancipimin e gruas por edhe për vlerësim të kontributit të saj.

Agjencia për Barazi Gjinore(ZKM)

Bashkëpunimi i vendimmarrësve me mediat dhe shoqërinë civile.

Faza e katërt e projektit u realizua nga Maji deri në Qershor 2012 dhe ka pas qëllim të sjellë së bashku përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve nga 4 komunat dhe të ballafaqoj ata me gratë vendimmarrëse, të ngrisin nivelin e debatit dhe të diskutoj çështjet e përbashkëta të të dyja grupeve të interesit, e kështu pra të ngrisë edhe bashkëpunimin në mes tyre.

Gjatë mbajtjes së Radio Debateve u vlerësua puna dhe bashkëpunimi i shoqërisë civile me ansambleistet si dhe u diskutua rreth çështjeve që lidhen me aktivitetet e projektit.

Mbatja e Radio debateve është një mundësi e mirë për ne janë shprehur asambleistet, sepse pikërisht media është ajo që pasqyron dhe formëson mendimin e opinionit publik, ajo që ndërton dhe shembë paragjykimet, varësisht nga roli që luan, që fabrikon apo shkatërron stereotipet negative në shoqëri. Po ashtu gjatë debateve u potencua fakti se " Jemi një shoqëri që ende s'kemi arritur t'i krijojmë mundësi të barabarta edhe gruas, prandaj na nevojitet përkrahja e mediave".

Nga Radio debatet kanë dalë edhe rekomandime si:

1. Të vazhdojë bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe mediat,
2. Mediat lokale duhet të kuptojnë se integriteti i grave në politikë e forcon demokracinë
3. Ndërtimi i balancit gjinor në mediat lokale
4. Respektimi i Ligjit për barazi Gjinore në skemat programore
5. Krijimi alternativave mediatiqe lokale që të dëgjohet më shumë zëri i grave
6. Të promovohet puna e aktivistëve për të drejta të njeriut dhe OJQ-ve që punojnë për gratë.



Stafi i OJQ-së "Zana" Klinë



SHQIPE DESKU

Gazetare në Radio "Alba" Klinë
Shkollimi: Fakulteti i komunikimit masiv-Gazetari

Deri me tani përfaqësimi i grave në politikë dhe në vendimmarrje nuk ka qenë në nivel të duhur ose të përcaktuar me ligj. Kjo për faktin së partitë politike, nuk kanë qenë dhe aq dashamirëse për krijimin e hapësirave për përfaqësimin e grave në politikë. Por përkundër të gjitha këtyre mendoj së gratë në politikë dhe vendimmarrje pëngohen nga vete gratë.

Edhe portretizimi i grave në media nuk është në nivelin e kënaqshëm. Më gjithate, ka disa media qoftë lokale apo nacionale të cilat kanë dhënë kontribut të jetë të madh në prezantimin e gruas në media. Edhe përkundër përpjekjeve të disa mediave që ti kushtojnë hapësirën e duhur pozitës së femrës në shoqëri, prapëseprapë vërehet së mediat kosovare akoma nuk iu kanë shmangur tërësisht stereotipeve gjinore. Dëshmi për këtë është fakti së në shumicën e rasteve, janë gratë gazetare, autore të emisionëve a storieve të cilat trajtojnë tema sociale, nga shëndetësia, kultura, arsimiti, ndërsa për programet me tema nga politika dhe vendimmarrja, në të shumtën e rasteve autorë janë gazetarët meshkuj.

Portretizimi i gruas është një çështje shumë dimensionale. Përfaqësimi i grave kërkon një përqindje më të lartë. Nëse nuk ka politika që balancit gjinor të respektohet atëherë aty mungon vetëdijësimi.



Dr. ILIRJANA Zeka Gafuri

Pejë
Subjekti politik: AAK
Nënkryetare e Aleancës së
Gruas në Kosovë
Shkollimi: Fakulteti i mjeksisë
(dega e oftomatologjisë)



Pozita dhe roli i gruas në Komunën tonë është duke u rritur dhe fuqizuar dita ditës, pjesëmarrja e saj në pozita vendimarrëse në këtë legjislacion është me i madhë, neve sot kemi një kryesuese të kuvendit Komunal Pejë, kemi dhe tre drejtoresha të drejtorive në komunë, por edhe 7 drejtoresha dhe një zëvendëse drejtoreshë në Shkollën e komunës së Pejës.

Mirëpo kjo nuk na ben që të jemi të kenaqura me përfaqësimin tonë i cili në përpjesëtim me përqindjen e gjinisë femër në popullësi zberthehet në përqindje të ulët, që nuk kap as vlerat e 18 %.

Duke u bazuar në infrastrukturën ligjore ekzistuese që mbron dhe fuqizon gruan që ajo të këtë mundësi dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën shoqërore politike, socioekonomike dhe kulturore mbetet sfida e grave që sot janë në politikë dhe në pozita vendimarrëse të punojnë gjithnjë në implementim të ligjeve ekzistuese dhe gjetjen e formave sa më të shpejta për fuqizim të gruas në Komunën tonë.

Në përgjithësi është edhe detyrë e subjekteve politike që brenda përbrenda strukturave të tyre të emertojnë në pozita të larta edhe gra dhe kështu të stimulojnë gruan të jetë aktive jo vetëm në politikë, por edhe në shoqëri, duke hapur kështu dyert e demokracisë në praktikë dhe duke siguruar edhe kriteret për integrim të shtetit dhe shoqërisë sonë në bashkësinë Evropiane.

Jemi të vetëdijshëm për mentalitetin dhe stereotipet familjare në gjithë Kosovën por edhe në komunën tonë, grua e ka të veshtirë të krijoj identitetin e saj brenda familjes e le me në shoqëri, por neve që sot jemi në politikë duhet të tregojmë sukses dyfish me shumë për hir të gjithë grave të cilat i përfaqësojmë dhe me suksesin tonë të jemi edhe shembull edhe në një formë " leje kalimi" për shumë gra që në të ardhmen do të integrohen në jetën politike dhe institucionale. Personalisht gjithmonë do përkrahe gruan dhe do bej "luftën" me meshkujt për të drejtën e grave dhe mundësitë e barabarta. Kjo duhet të jetë moto e gjithë grave, që neve të vlerësojmë dhe ta mbeshtesim njëra tjetrën në mënyrë që të kemi fuqinë që të kerkojmë mbeshtetje edhe nga gjinija tjetër, si dhe të kemi fuqinë dhe arsyeshmerin që nesër të dalim para popullit dhe të kerkojmë besimin, votën e tyre.